



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME KORÇË

Nr 479 prot

Korçë më 26.11.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun**

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, Përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", .

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësues të Teorisë dhe/ose Praktikes Profesionale me kohë të pjesëshme, 1 mësues, për "Degën Veterinari" me ngarkesë javore 8 orë mësimor.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësues të teorisë dhe/ose praktikës profesionale në Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- q) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- r) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- s) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- t) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- ë) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteria të posaçme si vijon:

- i) Të ketë diplomë Përkatese niveli Master profesional ose të barazvlefshem me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- j) Të ketë të paktën 1 (një) vite eksperiencë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

5. Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 të këtij udhëzimi
- c) Kartën e identitetit,
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- f) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
- e) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës... 17.12.2024

TATIANA MERO
DREJTOR I SHKOLLËS

